

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS OPŠTINA MITROVICA

02 06-030/01-0008339/26

Nr i Reg./Bilani

Datë/Date 12.02 2026

Sehens Mitrovicë - Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DREJTORIA E ADMINISTRATËS TË PËRGJITHSHME

***PLANI I PUNËS PËR PERIUDHËN
Janar-Dhjetor/2026***

Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut janë kriter bazë për pozitën e njeriut dhe rolin e tij në një shoqëri. Ato janë pjesë përbërëse e historisë politike të shoqërisë dhe paraqiten si tregues më i mirë i raportit mes shtetit dhe shoqërisë në njërën anë si dhe shoqërisë dhe individit në anën tjetër. Të drejtat e njeriut janë mjete dhe masa për kufizimin e pushtetit dhe pamundësimin e keqpërdorimit dhe arbitrimit me pushtetin.

Baza e të gjitha koncepteve demokratike, si dhe kërkesa e të gjitha lëvizjeve demokratike në historinë e zhvillimit shoqëror është orientuar në njohjen e të drejtave të dhe lirive njeriut, si dhe zgjerimin e lirive dhe të drejtave ekzistuese. Në botën bashkëkohore demokratike të drejtat e njeriut kanë prioritet, si në qasje e realizimit po ashtu edhe në mbrojtjen e tyre.

Të drejtat e njeriut dhe demokracia nuk mund të ndahen nga shteti ligjor, pasi që ato përbëjnë bazën e shtetit ligjor.

Edhe me gjithë ligjet në fuqi dhe ndërtimin e institucioneve nuk garantohen të drejtat e njeriut nëse shoqëria nuk është e informuar mbi këto të drejta. Është shumë e rëndësishme për të gjithë qytetarët të kuptojnë se ata nuk duhet toleruar shkeljen e të drejtave të tyre qoftë nga autoritetet apo edhe nga individët tjerë. Qytetarët në Kosovë, duke përfshirë edhe Mitrovicën me rrethinë, nuk janë të njohuara mbi të drejtat e tyre të garantuara. Mbizotëron një lloj nënshtrim i pavullnetshëm që është trashëguar nga tranzicionet e më hershme të shoqërisë kosovare. Në kohën e komunizmit dhe konfliktit, qytetarët ishin mësuar se shteti është aparat i dhunës dhe më të drejtë privon individin nga të drejtat e tij nëse e sheh të arsyeshme. Edhe pas krijimit të shtetit të Kosovës i cili pretendon të jetë shtet demokratik dhe liberal, qytetarët hezitojnë si pasojë e mos dijes të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre. Është e vështirë që gjeneratave të vjetra t'iu mësohet se shteti është në shërbim të tyre dhe se ata kanë mundësinë ligjore dhe institucionale t'iu kundërvihen në rast të shkeljeve të të drejtave të tyre nga ana e shtetit. Edukimi duhet të fillojë nga niveli më i ulët i mundshëm.

Në Kosovë më shumë se 42.5% e popullatës janë deri në moshën 19 vjeçare. Ky është një potencial i jashtëzakonshëm dhe në rast se ky potencial shfrytëzohet dhe edukohet për një periudhë 15 vjeçare, kultura jonë mbi të drejtat e njeriut do të ndryshoj rrënjësisht. Edukimi jo-formal është po ashtu njëra ndër format më të mira të edukimit qytetar. Organizatat e Shoqërisë Civile dhe institucionet tjera duhet të organizohen që t'i vizitojnë shkollat në Kosovë për të ligjëruar mbi të drejtat e njeriut. Arsimi luan një rol qendror në zhvillimin dhe përhapjen e vlerave themelore të shoqërive moderne e që janë: demokracia, të drejtat e njeriut dhe shteti i së drejtës, si dhe në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, arsimi, gjithnjë e më shumë, po shihet si barrierë ndaj rritjes së dhunës, racizmit, ekstremizmit, ksenofobisë, diskriminimit dhe in tolerancës. Probleme këto që janë të pranishme në kontekstin e Mitrovicës.

1. Arsyetimi i Planit

Edukimi për qytetari demokratike nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që ato synojnë përmes pajisjes së qytetarëve (të rinjëve) me

njohuri, aftësi, qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të ushtruar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri, për të vlerësuar diversitetin dhe për të luajtur një rol aktiv në jetën demokratike, për mbrojtjen dhe përparimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës. Edukimi për të drejtat e njeriut nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikën dhe veprimtaritë që ato synojnë, përmes pajisjes së qytetarëve (nxënësve) me njohuri, aftësi, qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të dhënë ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Projekti në fjalë synon të arrijë qëllimet e lartshënuara përmes debateve, trajnimeve cilësore dhe përmbajtjesore duke shfrytëzuar arsimimin jo formal i cili nënkupton çdo program të planifikuar arsimimi, jashtë mjediseve të arsimit formal, të hartuar për të përmirësuar një grup të caktuar aftësish dhe kompetencash.

Do të synohet adresimi i problemeve të qytetarëve përmes ngritjes së arsimit në sferën e të drejtave të njeriut, avokimin në zgjidhjen e problemit duke ju referuar të drejtave të njeriut dhe obligimeve të institucioneve, duke theksuar rolin e angazhimit të përbashkët, të orientuar dhe të bashkërenditur. Në këtë mënyrë, potenciali i të rinjve do të shndërrohet në faktor paqeje dhe stabiliteti.

2. Audienca Shënjestër

Plani synon të përfshijë të rinjtë nga bashkësitë e ndryshme etnike (shqiptarë, boshnjak, turq, romë, ashkali, etj.) nga Mitrovica, të moshave 12 – 18 vjeç të cilët vijojnë mësimet në shkollat fillore e të mesme në pjesët urbane dhe rurale të Mitrovicës;

3. Përshkrimi i aktivitetet

Plani synon të orientoj dhe edukoj qytetarët, sidomos të rinjtë, në sferën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut duke i aftësuar ata që t'i njohin parimet dhe ligjet që garantojnë liritë dhe të drejtat e tyre duke qenë në gjendje të dallojnë momentet kur ato mund të aplikohen në jetë. Kjo do të arrihet duke organizuar trajnime nëpër shkolla të pjesës urbane dhe rurale, duke organizuar debate tematike dhe aksione ndërgjegjëse për qytetarët.

Aktivitetet e planifikuar përfshijnë siç vijon:

- 1. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas (08.03.2026):** do të bëhet duke organizuar një debat lidhur me të drejtat e gruas në shoqërinë tonë, sukseset e arritura dhe sfidat me të cilat ballafaqohet gruaja në shoqërinë tonë. Të pranishëm do të jenë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe aktivistet e

mirënjohura për të drejtat e gruas. Konkluzionet e debatit do t'i komunikohen mediave të shkruara dhe atyre elektronike.

2. **Shënimi i Ditës Botërore të Shëndetit (07.04.2026):** do të bëhet duke organizuar një debat lidhur me të drejtat e njeriut të gjeneratës së dytë, me theks të veçantë të drejtat për sigurim dhe shërbim shëndetësor. Ndër të tjerat do të diskutohet çështja e ligjit mbi shëndetësinë dhe sigurimin shëndetësor, si dhe shërbimet shëndetësore publike primare dhe sekondare në komunën e Mitrovicës. Në debat do të ftohen përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe gazetar.

Dita kundër braktisjes së fëmijëve, me 18 Prill 2026, aktivitet të ndryshme kundër braktisjes së fëmijëve,

3. **Shënimi i Ditës Kombëtare të të Pagjeturve (27.04.2026):** do të bëhet në koordinim me shoqatën e familjarëve të personave të pagjetur me ç 'rast do të vizitohen shkolla në pjesën urbane dhe rurale të Mitrovicës dhe do të organizohen ligjërata për shkeljen e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare gjatë luftës së fundit në Kosovë si dhe për funksionimin e drejtësisë tranzicionale në kontekstin e Kosovës. Do të shtypet edhe një broshurë lidhur me shkeljet e bëra gjatë luftës së fundit ndaj qytetarëve të Mitrovicës dhe do t'u shpërndahet qytetarëve. Ligjërata në fjalë ka të bëjë me mbrojtjen ndërkombëtare që u bëhet personave që nuk marrin pjesë në konflikt, pra popullatës civile. Pra, gradualisht synohet të shtjellohet edhe ballafaqimi me të kaluarën. Nuk mund të ndërtohet e ardhmja pa u ballafaquar me të kaluarën dhe gabimi më i madh bëhet kur të rinjve u sugjerohet të harrohet e kaluara. Pra, të rinjtë duhet të dinë çfarë ka ndodhur në të kaluarën, cilat të drejta dhe konventa janë shkelur e pikërisht këto do ta mësojnë përmes këtij ligjërimi i cili do të elaborojë këto tema:

- Nocioni i së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- Historia e së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- Parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- Shkelja e të drejtës ndërkombëtare humanitare gjatë luftës në Kosovë;
- E drejta për të ditur fatin e personave të zhdukur sipas Konventave Ndërkombëtare;
- E drejta për të ditur sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës;

4. **Shënimi i Ditës Botërore të Punëtorëve (01.05.2026):** do të bëhet duke organizuar një debat lidhur me të drejtat e punëtorëve në shoqërinë tonë, sukseset e arritura dhe sfidat me të cilat ballafaqohen punëtorët, respektimin e ligjit të punës, etj. Të pranishëm do të jenë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe aktivistët e sindikatave.

Dita Ndërkombëtare e familjes "Java e Gruas", 15.05.2026

5. **Shënimi i Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor (20.05.2026):** do të bëhet duke organizuar një debat lidhur me diversitetin kulturor dhe multikulturalizmin në shoqërinë tonë. Të pranishëm do të jenë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike.

6. **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve (01.06.2026):** do të bëhet duke vizituar shkolla në pjesën urbane dhe rurale të Mitrovicës dhe do të organizohen ligjërata për të Drejtat e Fëmijëve. Do të shtypet edhe një broshurë lidhur me të drejtat e fëmijëve e cila do të shpërndahet nëpër shkolla. Organizimi i një tubimi ose ekskursioni me gratë kryefamiljare, në bashkëpunim dhe koordinim me OJQ-te, e grave, Shoqatën e Familjeve të dëshmoreve dhe shoqatën e të pagjeturve .

7. **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të Pagjeturve (30.08.2026):** do të bëhet në koordinim me shoqatën e familjarëve të personave të pagjetur me ç ‘rast do të organizohet një debat lidhur me të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur. Të ftuar do të jenë aktetë relevant që merren me çështjen e personave të zhdukur si: përfaqësues të shoqatave të familjarëve, përfaqësues të institucioneve vendore të nivelit lokal dhe qendror si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare. Në muajin gushte aktivitetet tjetër kemi menduar edhe Kampanjën për ruajtjen e ujit të pijshëm.

Muaji Tetor, Muaji i Mundësive të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuar, ku Komuna e Mitrovicës, që disa vite angazhon persona me aftësi të kufizuar të cilët punojnë për 5 dite në Administratën e Komunës

Në muajin Nëntor , Dita Ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave. 25.11.2026

Kemi menduar të bëjmë vetëdijesimin e grave për dhunë, shpërndarjen e fletëpalosjeve për të mos hezituar që të denoncojnë dhunën në familje, vizite në strehimore, si në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Mitrovicë etj.

8. **Shënimi i Ditës Kundër AIDS, ME 01.12.2026,** ku kemi planifikuar një Organizimin e një ligjërata dhe shpërndarje e fletushkave për mbrojtjen nga AIDS.

9. **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar (03.12.2026):** do të bëhet duke organizuar një debat tematik: ”Personat me aftësi të kufizuar dhe shoqëria jonë”. Debatin në fjalë synon ngritjen e vetëdijes në mesin e aktetëve relevant vendor dhe ndërkombëtar lidhur me të drejtat dhe problemet e personave me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrës të këtij debati do të jenë OJQ-të, autoritetet vendore/ndërkombëtare, persona me aftësi të kufizuar dhe përfaqësues të bizneseve të ndryshme, etj. Ndër të tjera përmes këtij debati do të theksohet në mënyrë të veçantë e drejta e pacenuar e personave me aftësi të kufizuar për dinjtet dhe mundësi të barabarta.

10. **Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (10.12.2026):** do të bëhet duke organizuar ligjërata nëpër shkollat fillore të qytetit të Mitrovicës dhe fshatrave përreth. Ligjëratat kanë për qëllim t’i njoftojnë nxënësit me historinë e të drejtave të njeriut, konceptin e të drejtave, ndarjen e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Trajnimi është konceptuar si i tillë që të zgjojë kërshërinë e pjesëmarrësve dhe të jetë interaktiv. Të rinjtë do të kenë rastin të mësojnë për të drejtat e njeriut nga trajnuesit më eminent të shoqërisë civile në Mitrovicë. Ata do të pajisen edhe më literaturë përkatëse për të drejtat e njeriut (fletushka, broshura). Përgjithësisht do të trajtohen të

drejtat e njeriut nga të tre gjeneratat: të drejtat civile dhe politike; të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore; të drejtat e reja apo të drejtat e solidaritetit. Për këtë qëllim do të vizitohen 6 shkolla në pjesën urbane dhe 6 në pjesën rurale. Gjithashtu do të dizajnohet edhe fletëpalosja për të drejtat e njeriut.

Plani i punës për Sektorin e Gjendjes Civile për vitin 2026

Qëllimi kryesor(Objektivat)	Aktiviteti(Detyrat)	Vërejtje
1. Përditësim dhe administrimi i regjistrave themeltar në formën elektronike dhe fizike. Përditësimi dhe administrimi i Regjistrit qendror i gjendjes civile dhe dhe adiministrim i regjistrave të të dhënave.	1 .Verifikimi i qytetarëve në regjistrin themeltare elektronik dhe unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrin themeltar fizik. 2. Mirëmbajtja dhe kujdesi i regjistrave themeltar fizik dhe elektronik dhe të dokumenteve të arkivuara. 3. Përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasëve në regjistrin themeltar dhe qendror, 4. Përditësimi dhe regjistrimi i qytetarëve sipas nenit 31 dhe 32 të ligjit për Shtetësi. 5. Përditësimi dhe regjistrimi në regjistrin themeltar dhe qendror të vendbanimit dhe vendqëndrimit, 6. Ri regjistrimi (Rikonstruksioni) i qytetarëve që dëshmojnë që kanë qenë të regjistruar më parë në regjistrin themeltarë. 7. Regjistrimi i shtetasëve të huaj në	

	regjistrin qendrorë, Regjistrimi i personave të natyralizuar sipas vendimit të MPB-së,	
2.Përdorimi dhe respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore në mënyrë të drejt dhe të saktë.	1.Përdorimi dhe zbatimi i ligjeve që kanë të bëjnë me gjendjen civile, 2.Përdorimi dhe zbatimi i udhëzimeve administrative që rregullojnë gjendjen civile, 3.Zbatimi i udhëzuesve dhe manualeve që kanë të bëjnë me procedurat e regjistrimeve dhe lëshimit të certifikatave të gjendjes civile, 4. Përdorimi dhe zbatimi i rregullorëve dhe manualeve që kanë të bëjnë me aplikacionin e gjendjes civile,	
3.Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile, shtypja , ruajtja dhe arkivimi i aktëve dhe dokumentëve të tjera.	1 .Zbatimi I vendimeve për ndryshimin dhe korrigjimin e të dhënave personale dhe shënimeve të më vonshme ne librin fizik. 2. Përcjellja e vendimeve për ndryshime dhe korrigjime të të dhënave personale në regjistrin themeltar dhe qendror. 3.Zbatimi i Aktgjykimeve të gjykatës për shkurorizim, 4.Zbatimi i vendimeve për regjistrim, ndërrim, korrigjim, 5.Zbatimi i raportit policor për dokumentet e humbura, 6. Zbatimi i deklaratës për kthimin e mbiemrit, 7. Zbatimi i deklaratës së Atësisë-Amësisë 8. Zbatimi i vendimit të gjykatës mbi themelimin e adoptimit. 9. Menaxhimi I EKIOSKA-ve.	

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Plani për funksionimin e Zyres për Shërbime me Qytetarë 2026

Me hyrjen në fuqi të Rregullores (MAP) Nr.01/2015 për Shenjat Unike të Klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre, Qendra për Shërbim me Qytetarë nga data 05.01. 2017 ka filluar dhe do të vazhdoj me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ndryshimi i shenjave unike të klasifikimit dhe afatet e ruajtjes së dokumenteve nënkupton se kanë ndryshuar rreth 80 % e shenjave të klasifikimit dhe poashtu ka ndryshuar edhe afati i ruajtjes së lëndëve.

Ligji Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në zyrë, parasheh të gjitha detyrat dhe përgjegjësit e vendit të punës për nënpunësit civil në QSHQ, të cilat parashiheshin sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2011 për Funksionimin e Qendrave për Shërbim me Qytetarë në Komuna të cekura si më poshtë:

Komunikimi korrekt dhe transparent me qytetar;

Përgaditja, vënia në dispozicion të qytetarëve e broshurave dhe fletëpalosjeve informative;

Këshillimi dhe ndihma juridike- administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtrësive;

Pranimi dhe regjistrimi i kërkesave ose parashtrësive;

Mbajtja e dosjeve dhe statistikave të parashtrësive dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët;

Mbajtja e dosjeve dhe statistikave të parashtrësive dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët;

Vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron zyra pritëse;

Sistemimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të lëndve të kryera sipas drejtorive;

Regjistrimin, ruajtjen dhe sistemin e materialit arkivor;

Bashkpunimi me arkivin nder komunal Mitrovicë;

Trajnimi i punëtorëve të këtij shërbimi në aspektin profesional;

Regjistrimi i kërkesave dhe lëndëve të kryera në kompjuter dhe ruajtjen e lëndëve arkivore;

Pajisja me literaturë profesionale nga lëmi i arkivit;

Dërgimi i lëndëve të cilave ju ka skaduar afati ligjor i

ruajtjes, në Arkivin ndër komunal në Mitrovicë

Në kuadër të planit vjetor lidhur me punën, krahas detyrave dhe përgjegjësi kjo zyre ka nevojë edhe për buxhet, buxhet ky i cili shërben vetëm për nevoja të punës esenciale lidhur me këtë qendër; mbështjellësa të lëndve që shkojnë në nr. më të madhë, leter, regjistrator, laps-kimik, ndonjë prishje eventuale të teknologjisë ku për një vit arrinë minamilisht deri 3000 euro.

Zyra për Shërbim me Qytetarë cdo herë është e gatshme të, organizoj dhe të pres në cdo konkurs, thirrje që parshihet për vitin 2026 nga Komuna e Mitrovicës, mirpo na duhen edhe (3) tre punëtor pasi që kemi mungesë të stafit.

Planet për vitin 2026:

Vazhdimi me skanimin apo Digjitalizimin e fondit arkivor.

- Të vazhdojmë me digjitalizimin (skanimin) e fondit arkivor **2002 – 2010** ku për këtë punë na duhen angazhimin e dhe shtimin e stafit në arkivë, momentalisht e kemi vetëm një nënpunës të angazhuar.

Sektori për Punë të Përbashkëta

Nr.	Objektivat	Aktivitete	Bartësit e aktiviteteve
1	Zbatimi i ligjit, kontratës së punës dhe detyrave sipas përshkrimit të vendit të punës. Identifikimi i nevojave për trajnimin e zyrtareve. Identifikimi dhe propozimi për rekrutimin e stafit të ri kur mbeten pozita të lira. Implementimi i sistemit të brendshëm përmes intranetit të zyrës së furnizimit me drejtorit komunale për pranim-dorëzimin e kërkesave blerje-furnizim me mallra.	Organizimi, mbikëqyrja, ndarja e punëve, vlerësimi, përgatitja e raporteve për punën e sektorit në përgjithësi dhe atë individuale të secilit për organin mbikëqyrës-Drejtorin. Trajnimi i zyrtarit në sistemin e menaxhimit të E-pasuria në kuadër të programit E-Qeverisja.	Shefi i Sektorit Zyrtari i furnizimit në bashkëpunim me zyren e TIK-ut
2	Ngritja e cilësisë, efikasitetit dhe efektshmërisë në punë dhe llogaridhënja. Raportimi në baza ditore javore, mujore dhe vjetore Ndërtimi i raporteve ndërnjerëzore Ofrimi i shërbimeve për të gjithë, pa dallime mbi të çfardo baze.	Kontaktimi i furnitorëve për furnizim me artikuj sipas cilësisë dhe vlerave të përcaktuara me kontratë, Kontrollimi i mallit, cilësia dhe sasia të përcaktuara sipas kërkesës	Zyrtari për furnizim
3	Pranim-dorëzimi i kërkesave për blerje, lëshim dhe pranim të mallit nga ana e organeve komunale dhe procedimi tek operatorët ekonomik duke u kujdesur në zbatimin e përpiktë të kontratës.	Regjistrimi në librin e faturave hyrëse. Protokolimi i lëndëve sipas arritjes, klasifikimi dhe ruajtja fizike e	Zyrtari i furnizimit për futjen e të dhënave në programin E-pasuria dhe depoisti

		lëndëve në regjistrator. Kontimi i hyrje daljeve të mallit. futja e të dhënave dhe ruajtja e tyre elektronike në sistemin e menaxhimit të E-pasuria në kuadër të programit E-Qeverisja	
4	Ngritja e cilësisë, efikasitetit dhe efektshmërisë në punë dhe llogaridhënja. Raportimi në baza ditore ,javore, mujore dhe vjetore	Verifikimi për pensionist që janë në jetë për rregullimin e pensionit jashtë shtetit, lajmrimi, çlajmrimi i vendqëndrimit, certifikata të gjendjes ekonomike, certifikata mbajtës të familjes. Flet Deshmi Mbi Vdekjen	Zyrtari për verifikimin e dokumenteve
5	Shtëpiaku: Ngritja e performances dhe ruajtjen më të mirë të pasurisë, uljen e shpenzimeve të mirëmbajtjes. Ngritja e efikasitetit dhe efektshmërisë në punë	Mirëmbajtja e objektit dhe hapësirave për rreth tij, Sanimi i prishjeve të shkatuara në rrjetin e ujësjellësit, të kanilizimit, në pastrimin e pusetave, rrjetit elektrik, nxemja qendrore, mirëmbajtja dhe kontrollimi i tyre, riparime të vazhdueshme në nyjet sanitare në objektin e komunës dhe në zyrat e vendit, riparimi i tavolinave ,	Shtëpiaku:

		karrikave dyerëve dhe dritareve etj.	
6	Zyrtari për fotokopje:	Fotokopjon i materialin për shërbime të kuvendit dhe organeve të tij. Bën mirëmbajtjen-pastrimin në kontinuitet të fokokopjeve si dhe bën riparimin e prishjeve të vogla. Shpërndarja e postes sipas destinacionit në adresa të përcaktuara nga dërguesi përmes librit të dërgesave, në kohën dhe vendin e duhur, duke u kujdesur në veçanti në ruajtjen e afateve ligjore. Mirëmbajtja e kamerave të vëzhgimit, ndërrimi dhe riparimi i tyre, administrimi i aksesit në përcjelljen e zhvillimeve brenda dhe jashtë hapësirave të objektit të komunës, vëzhgimi i hyrje-daljeve.	Zyrtari i fotokopjes, Korrieri dhe zyrtari i kamerave Vërejtëje.pas rinovimit të objektit kamera nuk ka.

Sektori i Teknologjisë Informative

- Menaxhon dhomën e serverëve, rrjetin e kompjuterëve dhe planifikimin e infrastrukturës së Teknologjisë Informative (TI).
- Administron dhe ofron përkrahje teknike për aplikacionet: **INTRANET**, **e-Pasuria**, **SMAED** (Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve), **SVP** (Sistemi i Vijueshmërisë në Punë), **HRMIS** (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore), **GJC** (Gjendja Civile), **QGIS** (databazë për PZHK), si dhe mirëmban ueb-faqen zyrtare të Komunës.
- Ofron përkrahje teknike për **DGJKP** lidhur me aplikacionet e **AKK-së**, si dhe për **DBZHR** rreth aplikacioneve për bujqësi.
- Mirëmban sistemin e pritjes në **Gjendjen Civile** dhe në **QSHQ**.
- Administron dhe pasuron **Active Directory (AD)**, si dhe mirëmban pajisjet për të siguruar performancë optimale.
- Monitoron mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe siguron transmetimin e tyre online.
- Mirëmban e kompjuterët, formatimin dhe instalimin e softuerëve të licencuar nga **MPB / ASHI**.
- Siguron ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave në serverë.
- Mirëmban rrjetin **LAN** në ndërtesën e Komunës.
- Ofron përkrahje teknike për shkollat lidhur me pajisjet e TI-së.
- Instalimi dhe konfigurimi i softuerëve të avancuar.
- Ofron përkrahje teknike për të gjitha institucionet shtetërore që operojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës, veçanërisht në çështjet që lidhen me rrjetin dhe infrastrukturën TI.

